

**RAMI MEMUSHAJ****NDIHESA TË PROF. SHABAN DEMIRAJT  
PËR ILIRËSINË E EPIRIT**

1. Një nga zbrazëtitë e kërkimeve albanologjike është mungesa e studimeve për lashtësinë dhe mesjetën e trevave në perëndim të Vjosës dhe të vargut të Pindit e deri në gjirin e Artës, që grekët e vjetër e quanin Epir. Veç tri-katër qyteteve të lashtësisë, në qendrat e tjera të banuara të këtyre trevave nuk janë bërë kërkime arkeologjike; nuk ka as ndonjë botim ndërdisiplinor ose edhe vetëm historik prej studiuesve shqiptarë për këtë trevë në lashtësi e mesjetë, sikundër është libri autoritar “Epiri” i historianit anglez N. Hamond.

Ndërkohë, fqinjët tanë jugorë kanë një letërsi historike shumë të pasur, jo vetëm në gjuhën greke, po edhe në gjuhët ndërkombëtare. Një nga këto botime është edhe përmbledhja e vëllimshme në anglishte “Epiri – 4000 vjet histori dhe qytetërim grek” (Epirus – 4000 Years of Greek History and Civilization, Athens, 1997), një libër që i drejtohet lexuesit të huaj. Në këtë përmbledhje me kontribute nga historianë të njohur grekë dhe të huaj, mbrohet teza e karakterit helen të Epirit të lashtë dhe, mbi këtë bazë, mëtimet greke për trojet jugore të vendit tonë.

Në parathënien e saj historiani grek Saqelariu si kufi verior të Epirit merr vijën nga mali Ivan në Akrokeraunet. Për të, Epiri dhe toka të tjera shqiptare kanë qenë djepi i Greqisë. “Përgjithësisht, – shkruan Saqelariu në pjesën e fundit të parathënies, – mund të thuhet se, që nga shek. XVII deri në Luftën Greke për Pavarësi, Epiri ka qenë një nga zonat më dinamike të Greqisë në shumë fusha... Megjithatë, territoret epirote u përfshinë në shtetin e ri grek më vonë dhe me faza... Më në fund, pjesa jugore e asaj që ka qenë historikisht Epiri u rikthye Greqisë dhe banorët e tij grekë iu bashkuan trungut kryesor helen.”<sup>1</sup>

Historiani tjetër grek Haxopulos, për të cilin fshatrat greqishtfolëse më veriore janë Narta e Vlorës dhe Zvërneci, “mbeturina të izoluara të të moçmëve Horikioi dhe Ballaiitai”, shkon edhe më tej në shtrembërimin e dëshmimeve të shkruara të autorëve të lashtë grekë, duke i quajtur pohimet e tyre për karakterin jogrek të Epirit si të habitshme. Sipas tij, “çështja e karakterit grek të epirotëve të lashtë nuk do të ishte ngritur, po të mos qe shtruar nga vetë autorët e lashtë grekë, të cilët herë u janë referuar epirotëve si barbarë dhe herë e kanë

---

<sup>1</sup> *Epirus – 4000 Years of Greek History and Civilization*, Athens, 1997, f. 11.

vendosur Epirin jashtë kufijve të Greqisë.” Pra, grekët e lashtësisë u kanë hapur telashe grekëve të rinj, që u duhet t’i korrigjojnë dhe t’i manipulojnë pohimet e tyre! Manipulimi ka të bëjë me kuptimin e termit “barbar”, që, sipas historianëve grekë të sotëm, “mund t’u referohet kritereve thjesht kulturore”, d.m.th. është përdorur për të treguar prapambetjen kulturore të epirotëve<sup>2</sup>.

Për të mbështetur mëtimet e tyre për Epirin, historianët grekë nuk pëlqejnë t’u referohen autorëve grekë të lashtësisë, dëshmitë e të cilëve për përkatësinë etnike johelene të fiseve epirote mbulojnë një periudhë kohore prej 6 shekujsh, nga Herodoti te Straboni. Çuditërisht, në ndihmë të historianëve të rinj grekë vjen edhe një nga njohësit më të mirë të Epirit, historiani anglez N. Hamondi, një dijetar me njohje të thellë të Epirit, tek i cili mbështetet Saqelariu.

Manipulimi i parë i historianëve grekë ka të bëjë me termin “barbar”. Sipas tyre, ky term “mund t’u referohet kritereve thjesht kulturore”, d.m.th. është përdorur nga autorët e lashtë për të treguar prapambetjen kulturore të epirotëve<sup>3</sup>. Lidhur me këtë, edhe Hamondi, duke u nisur nga ajo që molosët dhe fiset e varura prej tyre i shkruanin vendimet në greqishte, arrin në përfundimin që “këto fise flitnin greqisht pikërisht në kohën kur Tuqididi i quante barbarë”. Kjo pushon së qeni një paradoks, – vijon ai, – nëse kuptojmë që kontrasti në termin *barbaros* nuk ishte gjuhësor, po kulturor.”<sup>4</sup> Domethënë, fiset e Epirit dallonin prej fiseve helene jo etnikisht, po kulturorisht, si helenë të pakulturuar, të paqytetëruar.

Për manipulimin lidhur me etnicitetin e fiseve të Epirit historianët grekë mbështeten në hipotezën e Hamondit se “Shqipëria Qendrore dhe Epiri i Veriut në epokën e bronzit të mesëm ishin populluar kryesisht nga popuj greqishtfolës”<sup>5</sup>. Këtë mendim të shprehur në veprën “Epiri” Hamondi e shtjellon më tej në shkrimin e botuar në përmbledhjen “Epiri – 4000 vjet histori dhe qytetërim grek”, në të cilën, duke folur për epokën e bronzit, shkruan: “Baseni i popujve greqishtfolës prej të cilit ndodhën disa dyndje drejt Greqisë, ishin Maqedonia Perëndimore, Shqipëria e Mesme dhe Epiri. Pikërisht aty, në kushtet e një ekonomie kryesisht pastorale, u praktikuan në periudhën e mesme helladike (2100–1550 p.K.) institucionet patriarkale dhe fisnore të popullit grek, dialektet dhe ritet e tyre, duke përfshirë edhe varrimin e heronjve në tuma.”<sup>6</sup>

Për të mos u larguar nga tema, po mjaftohemi të vëmë në dukje se ky pohim i Hamondit vlen për periudhën e bronzit të mesëm, por jo për periudhën

<sup>2</sup> *Po aty*, f. 140.

<sup>3</sup> *Po aty*, f. 140.

<sup>4</sup> *Po aty*, f. 60.

<sup>5</sup> N. Hammond, *Epirus*, London, p. 406.

<sup>6</sup> *Po aty*, f. 36.

që nga epoka e bronzit të vonë 1550–1200 p.K. Mbështetur në gjetjet arkeologjike, historianët e arkeologët shqiptarë, përfshirë edhe shumë studiues të huaj, kanë arritur në përfundimin se në këtë periudhë këto treva banoreshin nga popullsi ilire<sup>7</sup>. Periudha nga fundi i epokës së bronzit dhe fillimi i epokës së hekurit përputhet me formimin e popujve historikë ilirë<sup>8</sup>. Në këtë kohë, grekët, ilirët dhe trakët ishin vendosur përfundimisht në trojet e tyre në Ballkan: grekët në jug, ilirët në perëndim dhe trakët në lindje. Pra, edhe nëse në periudhën e bronzit të mesëm Shqipëria e Mesme dhe Epiri ishin të populluar nga fise greke, gjatë bronzit të vonë në këto treva banonin fiset ilire. Dhe prej këndej nuk jemi larg periudhës historike, për të cilën kemi dëshmitë e autorëve të lashtësisë.

2. Me shtrembërime të tilla të historisë sonë dhe me mëtime të fqinjëve ndaj trojeve tona, shkencës shqiptare i është dashur të përballet që në fillimet e veta. Kjo situatë në të cilën ndodhet shkenca jonë ngjan me atë që po u ndodh pronarëve të ligjshëm, të cilët duhet të provojnë në gjyq jo se e zotërojnë një pronë, pasi kjo u është njohur me ligj, po të provojnë se ai që ua ka zaptuar, nuk është pronari i vërtetë. Por studimet historike shqiptare për Epirin janë shumë të pakta, me përjashtim të një numri artikujsh të shkruar nga arkeologët tanë.

Si një përpjekje modeste për ta mbushur këtë mungesë të studimeve për Epirin e lashtësisë dhe trevat shqiptare jugore mund të shohim veprën e prof. Sh. Demirajt “Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët” (2008). Ky libër u shkrua në kontekstin kur politika dhe shkenca greke në unison po punojnë ethshëm për ta paraqitur Epirin, d.m.th. Shqipërinë e Jugut dhe trevat nga Gjiri i Artës e deri në kufirin shtetëror me Shqipërinë, si tokë greke të banuar që nga lashtësia prej grekësh etnikë dhe kur në qytetin e Himarës elementët grekofilë deklarojnë se himarjotët janë pakicë greke dhe Himara është Eladhë. Pikërisht në këtë periudhë prof. Demiraj i propozoi kryesisë së Akademisë së Shkencave të bëhej një botim për Epirin, si ai për Himarën më 2004. Si nuk mori përgjigje, iu përvesh i vetëm punës, duke arritur të na japë këtë vepër me vlerë.<sup>9</sup>

<sup>7</sup> *Historia e Shqipërisë*, vëll. I, 1967, f. 50.; M. Korkuti, *Parailirët, Ilirët, Arbërit*, TOENA, 2003, f. 50.

<sup>8</sup> J. Wilkes, *The Illyrians*, Blackwell Publishers, Cambridge, Massachusetts, 1996, f. 39.

<sup>9</sup> Në të vërtetë, prof. Demiraj kishte në plan të shkruante një vepër për mesapët dhe mesapishten. Për këtë ai kishte nisur të mblidhte literaturë, por, duke e kuptuar se të shkruaje për këtë temë, duheshin bërë kërkime në terren (në Italinë e Jugut, ku ruhen mbishkrimet mesape) dhe në biblioteka, gjë që nuk ia lejonin as mundësitë materiale dhe as moshën, ai hoqi dorë prej këtij plani.

Për ndriçimin e prejardhjes së një populli kontribuojnë një varg shkencash, si historia, arkeologjia, etnografia, gjuhësia, antropologjia etj. Po roli i këtyre disiplinave nuk është i njëjtë për të gjitha periudhat. Për periudhën parahistorike, arkeologjia, e ndihmuar nga antropologjia e etnografia, mbeten fushat kryesore të kërkimit; kur hyjmë në epokën historike, në ballë dalin historia dhe gjuhësia<sup>10</sup>.

Pikërisht, duke filluar nga periudha historike, ndihmesat e gjuhësisë historike në ndriçimin e prejardhjes së shqiptarëve kanë qenë jo më pak të rëndësishme se dëshmitë arkeologjike dhe historike. Këtu janë shquar për ndihmesat e tyre një varg gjuhëtarësh të huaj dhe ndër shqiptarët Eqrem Çabej dhe Shaban Demiraj.

Ndryshe nga E. Çabej, që, duke punuar tërë kohën në fushën e historisë së gjuhës, u përpoq të ndriçonte problemet e autoktonisë dhe të prejardhjes së shqiptarëve, Shaban Demiraj e ka nisur veprimtarinë shkencore si morfolog i shqipes së sotme, duke kaluar prej saj te morfologjia historike dhe për të përfunduar në problemet e historisë së popullit tonë. Ky kalim në çështjet e historisë së gjuhës dhe të popullit tonë nuk ka asgjë të jashtëzakonshme. Analiza historike dhe krahasimi i fakteve gjuhësore të shqipes me faktet e gjuhëve të tjera të shpie natyrshëm në portat e historisë. Mjafton vetëm një hap për t'u gjetur brenda. Kështu ka ndodhur edhe me këtë gjuhëtar. Krahas tekstit universitar në dy vëllime "Morfologjia historike e gjuhës shqipe", që u pasua nga kryevepra "Gramatikë historike e gjuhës shqipe" dhe "Gjuhësi ballkanike", prof. Demiraj na ka dhënë tri monografi që merren drejtpërdrejt me historinë e popullit tonë: "Gjuha shqipe dhe historia e saj" (1988), "Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe" (1999) dhe "Epiri, etruskët dhe shqiptarët" (2008).

Pavarësisht nga përmbajtja e ndryshme, ajo që i bashkon këto tri vepra është përpjekja e autorit për të ndriçuar me të dhëna gjuhësore historinë e popullit që flet gjuhën shqipe, pra se si "mund të ndihmojnë dëshmitë e gjalla të gjuhës shqipe për të ndriçuar disa çështje të diskutueshme të historisë së lashtë të popullit shqiptar"<sup>11</sup>. Kalimi i këtij gjuhëtar nga çështjet e historisë së gjuhës te çështjet e historisë së shqiptarëve është i shkallëshkallshëm. Kështu, libri "Gjuha shqipe dhe historia e saj" paraqitet si një vepër sintetizuese për historinë e "evolucionit të nënës së shqipes në truallin ballkanik", në të cilën faktet gjuhësore vendosen në shkallën historike, duke ndihmuar tërthorazi në ndriçimin e çështjeve të historisë së popullit që e flet këtë gjuhë. Ndërsa në dy librat e fundit vëmendja zhvendoset nga historia e shqipes te historia e popullit që e flet. Në ta synohet të tregohet, siç shprehet autori, se si "mund të

<sup>10</sup> M. Korkuti, *Parailirët, Ilirët, Arbërit*, TOENA, 2003, f. 53.

<sup>11</sup> Sh. Demiraj, *Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe*, Shtëpia Botuese "Shkenca", Tiranë, 1999, f. 35.

ndihmojnë dëshmitë e gjalla të gjuhës shqipe për të ndriçuar disa çështje të diskutueshme të historisë së lashtë të popullit shqiptar<sup>12</sup>.

Të dyja janë vepra sintetizuese, në të cilat, në përputhje me logjikën e kërkimit shkencor, përpara se të japë mendimet e veta, autori bën një paraqitje të hollësishme të ndihmesave të sjella nga të tjerët. Veçori e stilit të tij është se nuk është kategorik në pohimet që bën. Gjykimi i tij është objektiv, i zhveshur nga notat e patriotizmit ose nga pasioni i një fillestari në shkencë, gjë që i bën më të besueshme dhe më të qëndrueshme përfundimet. Kjo mënyrë të shkruari jo si monolog me vetveten, po si dialog, nënkupton edhe praninë e kundërshtarit, por ky duhet të mendohet mirë para se të përgjigjet. Kështu, gjatë gjithë veprës, kur arrin në përfundime të caktuara, autori ngre hipoteza që bien në kundërshtim të hapur me të vërtetat e njohura dhe me bindjen e tij, duke lëshuar pe deri atje sa të supozojë edhe të pamundshmen, por më në fund kërkon që këto hipoteza të vërtetohen.

**3. Përcaktimi i kufijve të shtrirjes së gjuhës së paraardhësve të shqiptarëve përbën objektin e kreut të parë të veprës “Prejardhja e shqiptarëve...”** Nga gjuhët e Ballkanit të lashtësisë, autori ndalet te gjuha e Ilirëve dhe e banorëve të Epirit, duke mos u marrë me greqishten e trakishten, por edhe me maqedonishten. Për këtë të fundit thotë se “mbetet e hapur se a ka qenë dialekt i greqishtes, apo gjuhë më vete”<sup>13</sup>, duke mbajtur po atë qëndrim të tërhequr si Çabej dhe studiues të tjerë shqiptarë, që ua kanë lënë maqedonët grekëve, edhe pse tek autorët e vjetër grekë quhen barbarë” dhe Straboni thotë se zakonet, mënyra si vishen dhe si i mbajnë flokët i kanë të njëjta me ilirët dhe epirotët, pa folur për elementin etnik ilir dhe dëshmi të tjera që provojnë se maqedonët nuk ishin grekë dhe as trakë.

Lidhur me emrin e banorëve të lashtë të Epirit, autori thotë se nuk dihet se si e kanë quajtur veten banorët e tij. Për ta ai mendon se “ka shumë të ngjarë që edhe banorët e të ashtuquajturit Epir në pjesën më të madhe të ishin prej origjine ilirë”<sup>14</sup>, kurse për gjuhën e tyre thotë që “banorët e lashtë të asaj treve, në pjesën më të madhe, kanë folur një gjuhë, e cila nëpërmjet evolucionit të saj të shkallëshkallshëm ka dhënë variantin jugor të shqipes së sotme”<sup>15</sup>. Duke qenë se kufijtë e Epirit të lashtësisë me fiset helene kanë qenë të dalluar qartë, ne nuk do të pajtoheshim me qëndrimin e moderuar, të shprehur në fjalët “në pjesën më të madhe”. Autorët e lashtë grekë i përcaktojnë me saktësi kufijtë e Epirit, me liqenin e Artës në jug, me malet e Pindit dhe Vjosën në Lindje, dhe amantët në veri. Ndërsa për gjuhën e tyre mund të mbështetemi te Straboni (63

<sup>12</sup> Sh. Demiraj, *Prejardhja e shqiptarëve...*, f. 35.

<sup>13</sup> *Po aty*, f. 51.

<sup>14</sup> *Po aty*, f. 56.

<sup>15</sup> *Po aty*, f. 54.

p.K.-24 e.r.), burimi më i sigurt për periudhën kur ndikimit grek ia pat zënë vendin prej dy shekujsh ndikimi roman, i cili thotë se i gjithë vendi nga Maqedonia deri në ishullin e Korkyrës quhet prej disave Maqedoni dhe se banorët e tij gjuhën, zakonet, mënyrën si vishen dhe si i presin flokët i kanë të njëjta<sup>16</sup>. Po aty, Straboni shton për ta se disa janë bilingë, por nuk përmend ndonjë fis të Epirit që fliste vetëm greqisht. Pra, po të kuptojmë me “banorë” pjesëtarët e fiseve të Epirit, jo në pjesën më të madhe, po të gjitha fiset e Epirit ishin ilire dhe kanë folur një gjuhë të përbashkët me fiset ilire në veri të Vjosës. Sipas autorit “një pjesë e konsiderueshme e kësaj popullsie, falë karakterit kryesisht malor të vendbanimeve të saj si edhe të jetës, në përgjithësi, të mbyllur fisnore, munda ta ruante gjuhën e të parëve dhe identitetin e saj<sup>17</sup>. Kjo gjuhë paraardhëse e toskërishtes së sotme ishte varianti jugor i ilirishtes.

Nëse qëllimi i veprës “Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe” është të provojë me argumente gjuhësore prejardhjen ilire dhe autoktoninë e shqiptarëve, vepra “Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët” ka një qëllim tjetër: të vërtetojë ilirësinë e Epirit dhe të tregojë se trojet etnike shqiptare që këto kohët e fundit po përpiqen t’i paraqesin si greke, kanë qenë banuar që nga lashtësia prej stërgjyshërve të shqiptarëve dhe në kohët e reja janë banuar e banohen prej shqiptarëve. Si rrjedhim, pjesa kryesore e këtij libri u kushtohet çështjeve të karakterit etnik në lashtësi, në mesjetë dhe në kohët e reja atij që quhet Epir dhe gjuhës amtare të banorëve të tij.

Karakteristike për mënyrën e të arsyetuarit të autorit është se ngre hipoteza që bien në kundërshtim të hapur me të vërtetat e njohura dhe me bindjen e tij, madje duke lëshuar pe deri atje sa të supozojë edhe të pamundshmen. Pastaj, duke u mbështetur në faktet, i rrëzon këto hipoteza, duke vërtetuar të kundërtën e asaj që parashtron në fillim. Pra, ai nuk është kategorik në pohimet e tij. Gjykimi i tij është objektiv, i zhveshur nga notat e patriotizmit apo nga pasioni i një fillestari në shkencë dhe kjo i bën më të besueshme dhe më të qëndrueshme përfundimet, që nxirren pas analizash të thukëta, duke mos i paraqitur ato si aksioma pa vërtetim.

Argumentet që sjell në këto vepra në mbrojtje të ilirësisë së popullsisë që banon në trojet e dikurshme të ilirëve dhe të epirotëve, janë të rrafshëve të ndryshme: leksiku i huazuar grek e latin, termat kishtarë latinë, onomastika e lashtë (toponimet, hidronimet, antroponimet) dhe dukuri gjuhësore. Nga këto argumente, do të lëmë mënjanë ato që vlejné për të dy krahët e trevave ilire dhe do të ndalemi në ato që kanë lidhje veçanërisht me Epirin. Kështu, fakti që huazimet latine e greke, përfshirë edhe termat kishtarë kanë të njëjtën trajtë edhe në trevat në jug të Vjosës, edhe në trevat në veri të saj, është një dëshmi e

<sup>16</sup> Strabo, *Geography*, VII, Book VII.8.

<sup>17</sup> *Po aty*, f. 63.

fortë se banorët e Ilirisë dhe të Epirit kanë folur të njëjtën gjuhë dhe kanë qenë të së njëjtës racë.

Si pasojë e pushtimit romak, harta etnike e Ballkanit nga shek. II e deri në prag të dyndjeve sllave pat pësuar ndryshime të mëdha: dalmatët në veri dhe dakët në lindje qenë romanizuar, ndikimi i gjuhës dhe i kulturës romane kishte prekur pjesërisht edhe popullsinë që banonte në trevat ku sot jetojnë shqiptarët. Megjithatë, ndikimi latin e pastaj ai sllav mbi gjuhën e trevave të Ilirisë Jugore dhe të Epirit nuk qe i vogël. Një pjesë e madhe toponimesh ilire u zëvendësuan me emërtimet me emërtime latine dhe këto pastaj me emërtime sllave, por një pjesë e onomastikës vendëse u ruajt. Në mungesë të dëshmimeve të shkruara të gjuhës së të parëve tanë, si të parat edhe të dytat ai i bën objekt analizash për të provuar se si emërtimet romane, dhe ato sllave kanë kaluar nëpër gojën e shqiptarëve.

Në përfundim të shqyrtimit të huazimeve nga greqishtja e vjetër e latinishtja, terminologjisë kishtare, emrave të vjetër të krishterë dhe të toponimeve e hidronimeve të lashta, Demiraj arrin në përfundimin se “trajtat e sotme të emrave të shqyrtuar, vështruar në përqasje me trajtat e tyre të hershme, paraqiten me ndryshime të tilla që janë në përputhje me ligjësitë e evolucionit fonetik të shqipes. E kjo dëshmon se ata emra janë përdorur pa ndërprerje nga shqiptarët a arbëreshët qysh nga kohët e lashta. Pra, parë në dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe del se stërgjyshërit e shqiptarëve kanë qenë fqinjët veriperëndimorë të grekëve të vjetër”<sup>18</sup>.

Nga dukuritë gjuhësore më me peshë që sjell, po përmendim dukuritë e rotacizmi *n/r* dhe errësimi *a > ë, e > ë* (*ranë / rërë, Vlonë / Vlorë*), që kanë ndodhur në trojet në jug të lumit të Shkumbinit. Sipas nesh, vetë rotacizmi dhe ndërrimi *a > ë* që e shoqëron, si dy tipare themelore dalluese dialektore, janë me shumë rëndësi për lashtësinë e shqiptarëve dhe të dialekteve të gjuhës së tyre. Fakti që huazimet sllave nuk u janë nënshtruar këtyre dy dukurive, do të thotë se në shek. VII ato kishin pushuar së vepruari. Kjo dëshmon se ndarja dialektore e shqipes është shumë më e vjetër dhe se kjo ndarje ka ndodhur në këtë truall, të paktën dy-tre shekuj para dyndjeve sllave. Ndarja dialektore e shqipes, vëren autori, “parakupton edhe hapësirat gjeografike ku janë zhvilluar dialektet dhe nëndialektet e kësaj gjuhe”<sup>19</sup>. Këto dy dukuri që i dallojnë dy dialektet e shqipes “nuk mund të zhvilloheshin veçse në trevat e sotme shqipfolëse”<sup>20</sup>, pasi është jashtë logjikës dhe pa asnjë mbështetje historike mendimi që këto dukuri të jenë zhvilluar në territore të tjera dhe të jenë bartur në trojet e sotme të toskërishtes.

<sup>18</sup> Sh. Demiraj, *Prejardhja e shqiptarëve...*, f. 174.

<sup>19</sup> Sh. Demiraj, *Epiri, pellazgët...*, vep. e cit., f. 75.

<sup>20</sup> *Po aty*, f. 75.

Kur flasim për vjetërsinë e këtyre dy dukurive dialektore, duhet të kemi parasysh rrethanat historike të shekujve të parë të erës sonë, gjatë të cilave ndarjet administrative të territorit ilir nga pushtuesi romak shpunë në shuarjen e fiseve dhe në krijimin e bashkësisë arbërore që u zuri vendin bashkësive ilire. Kjo do të ketë ndodhur, të paktën, që nga shek. V i erës sonë, kur ndodhi shuarja e bashkësive fisnore. Pra, popullsia arbëreshe që fliste dy dialekte të së njëjtës gjuhë, është në këto troje të paktën që nga shek. V. Mirëpo, kur flasim për ndarje, kjo nënkupton automatikisht një periudhë të mëparshme po në ato troje kur këto dallime nuk ishin shfaqur (siç e dëshmon në gegërishte prania e *n*-së së huazimeve greke *lakën*, *mokën* e latine *kurpën*, *shullan* etj., që në të folmet geqe ka mbetur e pandryshuar), e cila shtyhet nga shekulli V drejt lashtësisë ilire.

4. Autorët që u mohojnë autoktoninë fiseve të Epirit si argumentin më të fortë kanë lëvizjet e popullsisë, duke i vendosur e zhvendosur sipas dëshirës të parët e shqiptarëve dhe shqiptarët nga trojet e tyre etnike. Pikërisht, pjesa kryesore e këtij libri u kushtohet çështjeve të karakterit etnik të Epirit në lashtësi, në mesjetë dhe në kohët e reja si dhe të gjuhës amtare të banorëve të tij. Duke polemizuar me autorë grekë se popullsia e Epirit “mund të jetë e ardhur dhe të ketë zëvendësuar një popullsi të mëparshme greqishtfolëse a të helenizuar”<sup>21</sup>, Demiraj vëren se, së pari, mungojnë dëshmitë historike që mund të hidhnin dritë për ndonjë shpërngulje të tillë popullsie dhe, së dyti, se një popullsi ardhëse nuk mund të helenizonte një popullsi greke, që favorizohej nga sundimi bizantin dhe kisha greke.

Në mungesë të dëshmive historike, për të mbrojtur karakterin ilir të fiseve epirote ai u drejtohet fakteve gjuhësore, dëshmive të vetë gjuhës shqipe: mënyrës si janë pasqyruar tingujt e gjuhëve klasike në shqipe, onomastikës dhe ndarjes dialektore. Një provë të autoktonisë së banorëve të lashtë të Epirit, ai e gjen te mënyra se si janë pasqyruar tingujt e huazimeve greke të vjetra dhe latine në shqipe. Që të parët e shqiptarëve kanë qenë në kontakte të drejtpërdrejta me grekët e vjetër, u referohet fjalëve *lakën*, *bretk*, *mokër* etj., të cilat mungojnë në latinishte ose dalin në këtë gjuhë në një trajtë tjetër. Kështu, *lakën* e *bretk* mungojnë në latinishte dhe kjo është një provë e pakundërshtueshme se këto fjalë kanë hyrë në gjuhën e të parëve të shqiptarëve drejtpërdrejt nga greqishtja. Ndërsa fjalën *mokër*, që e ka edhe latinishtja në trajtën *makina*, gjuha mëmë e shqipes nuk e ka prej latinishtes, pasi /a/ latine nuk ka dhënë kurrë /o/ në shqipe; veç kësaj, grupi *chi* i lat. do të kishte dhënë /q/ në shqipe si te *cicer* > *qiqër*, *facies* > *faqe*. Pra, *mokër* është huazuar nga dorishtja *mâkhaná*, ku kemi ndërrimin *ā* > *o*, ndërrim që ka ndodhur edhe në fjalë i.e., si *mater* > *motër* etj. Kjo tregon se huazimi dorik është shumë i

<sup>21</sup> *Po aty*, f. 74.

vjetër. Si provë tjetër të kontakteve gjuhësore të të parëve të shqiptarëve me grekët sjell kalimin e /k<sup>h</sup>/ të frymëtuar të greq. në /k/ te *bretëk*; po ashtu, shqiptimi i fjalës βρόταχος “bretëk” me /b/ tregon se fjala është huazuar para kohës kur /β/ filloi të shqiptohej /v/ në greqishte, d.m.th. para shek. II p. K.<sup>22</sup>

Edhe për sa u takon kontakteve të mëmës së shqipes me latinishten, autori sjell një varg argumentesh. Së pari, reflektimin në shqipe të tingujve zanorë e bashkëtingëllorë të latinishtes. Kështu, mbylltorja grykore *k* para zanoreve *i* dhe *e* të fjalëve latine është ruajtur e pandryshuar në gjuhën shqipe, si p.sh. në fjalët *peshk*, *qiell* etj., refleks tingullor vetëm i shqipes që pasqyron “shqiptimin romak të kohës së Augustit” (Gaius Octavius, perandor romak, 63 p. K. –14 i erës së re) të tingujve grykorë. Kjo do të thotë se kemi të bëjmë me huazime shumë të lashta të shqipes prej latinishtes, që kanë shtrirje në mbarë trojet arbërore. Edhe shembuj të tjerë, si pasqyrimi i një zanoreje *o* të fjalëve latine në *e* në shqipen, si në fjalët *pomum* > *pemë*, *hora* > *herë*, dëshmojnë se ndikimi i latinishtes mbi nënën e shqipes ka nisur mjaft herët, që në shek. II para Krishtit. Kjo, nga ana e vet, do të thotë që banorët e lashtë të Epirit i kanë marrë këto fjalë drejtpërdrejt nga romakët dhe në trojet ku banojnë sot pasardhësit e tyre.

Si një provë tjetër se banorët e Epirit nuk janë ardhacakë në trojet ku gjenden sot, autori sjell mënyrën se si shqiptohen termat kishtarë, emrat e vjetër të krishterë, si *Lekë* (Aleksandër), *Gjon* (Joannes), *Gjin*, *Pal* (Paulus) e *Pjetër* (Petrus; mënyrën se si emrat grekë të qyteteve *Aulon*, *Oricum*, *Hadrianopolis* kanë përfunduar në *Vlorë*, *Orik*, *Dropull*, njëlloj si emrat *Durrës*, *Lezhë* etj. në trevat veriore të shqipes. Edhe në këto raste, ndryshimet tingullore të këtyre fjalëve dëshmojnë se ato kanë kaluar brez pas brezi në gojën e shqiptarëve. Përndryshe, po të kishin qenë grekë banorët e këtyre qyteteve, nuk do të kishim rotacizim të *n*-së te *Vlorë* dhe as *d* te *Dropull*, po *dh* si në shqiptimin grek *Dhropolis* të kësaj fjale etj.

Me mjaft interes është emri i lumit *Vjosë*, tek i cili prof. Demiraj është ndalur shumë gjatë, duke dhënë të gjitha fazat e evolucionit të tij nga trajta më e vjetër *aoo* te trajta e sotme. Ai anon nga hipoteza se kalimi *Aoó* > *Voós* > *Viosë* është kryer në mjedis arbëresh, po duke e lënë të hapur problemin për hulumtime të mëtejshme. Tek trajtat më të vjetra të këtij emri, *Aeas* te *Hekateu* (rreth 550 p.K – 476 e.r.), *Aoüs* te *Straboni* (63/64 p.K. – 24 e.r.)<sup>23</sup>, *Aous* (“flumen Aous, a quibusdam Aeas nominatum”) te *Plini* (23 p.K –79 e.r.)<sup>24</sup>, *Aoo*

<sup>22</sup> Po ai, *Prejardhja e shqiptarëve...*, vep. e cit., f. 127.

<sup>23</sup> *Strabo*, *Geography*, VII.V.8. Në shënimin 23, *Straboni*, duke iu referuar fjalës *aea* që del te *Homeri*, thotë se kjo fjalë nuk ka kuptimin “tokë”, sikundër mendonin disa. Sipas tij, *Aea* është emri i një burimi afër qytetit të lashtë *Amydon* që derdhej në lumin *Aksus* (*Vardar*).

<sup>24</sup> *Plinius*, *Historia naturalis*, Liber 3.XXIII.145.

(Vjosa) e *Aoi stena* (gryka e Ujit, gryka e Këlcyrës sot) tek Tit Livi (59 p.K – 17 e.r.), *Aóo potamo* te Cassius Dio (shek. II–III e.r.)<sup>25</sup>, ne besojmë fort se kemi shqiptimin ilir të fjalës shqipe *ujë*. Fakti që një lumë të thirret me një emër të përgjithshëm, përbën një gjë normale jo vetëm në shqipe. Edhe emrat shqip të disa prej lumenjve të trojeve shqiptare, si Vardar, Bunë, Shkumbin, rrjedhin nga apelativë.

Duke analizuar dhe shpjeguar në mënyrë bindëse faktet e mësipërme, autori arrin në përfundimin se “...trajtat e sotme të emrave të shqyrtuar, vështruar në përqasje me trajtat e tyre të hershme, paraqiten me ndryshime të tilla që janë në përputhje me ligjësitë e evolucionit fonetik të shqipes. E kjo dëshmon se ata emra janë përdorur pa ndërprerje nga shqiptarët a arbëreshët qysh nga kohët e lashta. Pra, parë në dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe del se stërgjyshërit e shqiptarëve kanë qenë fqinjët veriperëndimorë të grekëve të vjetër.”<sup>26</sup>

5. Për gjendjen etnike të Epirit dhe gjuhën e banorëve të tij pas pushtimit osman, autori u referohet të dhënave onomastike të defterëve osmanë të shek XV–XVI për vendbanimet skajore shqiptare të Epirit, si Arta e Janina të Molosisë së lashtë, Preveza, Ajdonati (Paramithia) e Mazaraku në Çamëri (1551 dhe 1583), por edhe për ato brenda kufijve, si Dropulli (1519–20), Vurgu (1431–32), Himara (1583) dhe Narta e Vlorës (1583). Në listat e kryefamiljarëve të këtyre defterëve gjenden, së pari, emra të përveçëm e llagape që vijnë prej emrash të përgjithshëm shqip, si *Babi, Bardhi, Çuni, Bukëvala, Buzi, Buzëmadhi, Dreri, Lakra, Lula, Prifti, Prushi, Zoto* etj. Së dyti, në këta defterë gjenden një numër i madh emrash e llagapësh, që ndonëse me prejardhje të huaj, në gojën e shqiptarëve kanë përfunduar në të njëjtën trajtë si në jug edhe në veri të vendit, si *Gjon, Gjokë, Gjini, Lekë, Pal, Pjetër, Dhimë, Kolë, Kond, Ndre* etj. Të dyja klasat e këtyre emrave dëshmojnë në mënyrë të pakundërshtueshme se këto troje kanë qenë të banuara nga shqiptarë.

Por në çdo rast autori nuk lë pa vënë në dukje edhe se, krahas trajtave shqipe të emrave të grupit të dytë, në defterët osmanë shfaqen me një denduri që me kalimin e shekujve vjen duke u rritur, edhe trajtat greke, gjë që e merr si një dëshmi të shtimit të ndikimit grek në trevat e Jugut.

Një vend jo i vogël i lihet në këtë vepër çështjes së tri fshatrave greqishtfolëse në një trevë etnike shqiptare, siç është zona e Himarës. Duke u mbështetur në të dhënat e regjistrave osmanë, në dëshmitë e murgjve bazilianë që vepruan në shek. XVI–XVIII në këtë krahinë, sidomos të atyre me prejardhje greke, në doket dhe zakonet e himarjotëve, si dhe në veçoritë e së folmes së Himarës, autori arrin në përfundimin se gjuha amtare e banorëve të

<sup>25</sup> Shih: Hammond, *Epirus*, 1967, p. 232.

<sup>26</sup> Sh. Demiraj, *Prejardhja e shqiptarëve...*, vep. e cit., f. 174.

këtyre tri fshatrave është shqipja, ndërsa greqishtja është gjuhë e fituar falë kontakteve ekonomike e tregtare me grekët, sidomos pas shpalljes së pavarësisë së Greqisë, dhe ndikimit të madh të kishës e të shkollës greke tre shekujt e fundit<sup>27</sup>. Sidoqoftë, autori thekson nevojën e studimit të greqishtes së këtyre fshatrave për të përcaktuar lidhjet e saj në ndarjen dialektore të greqishtes, gjë që do të ndihmonte në sqarimin më të plotë të këtij problemi. Si argument tjetër për shqipen si gjuhë rrënjëse e krahinës së Himarës, autori sjell faktin që e folmja e fshatrave të kësaj treve nuk është tjetër veçse një degëzim i nëndialektit lab. Sipas tij, veçoritë e njëjta të të folmeve të bregdetit himarjot me ato të viseve të brendshme të Labërisë mund të shpjegohen vetëm me atë që tipare të njëjta dialektore mund të ndodhin vetëm kur banorët janë vendës dhe në kontakte të pandërprera me njëri-tjetrin<sup>28</sup>.

Këto ndihmesa të prof. Demirajt, të cilat u përpoqëm t'i vëmë në dukje në këtë artikull, përbëjnë një bazë të mirë ku mund të mbështeten albanologët për t'i shpurë me tej studimet për ilirësinë e Epirit dhe për të mbushur gollet e mbetura në këtë fushë.

---

<sup>27</sup> *Po aty*, f. 146.

<sup>28</sup> Sh. Demiraj, *Epiri, Pellazgët...*, vep. e cit., f. 147.

